



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

Nr. 55-43 Prot.

Ballsh, më 05.11.2025

**NJOFTIM PËR NXËNËSIT E ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL
NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR
2025-2026**

Njoftojmë se të gjithë nxënësit e arsimit të mesëm profesional në institucionet arsimore publike të vitit shkollor 2025-2026, me vendbanim në territorin e Bashkisë Mallakastër, të interesuar për aplikimin për bursë sipas VKM-së nr.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, ndryshuar, brenda datës **30.11.2025**, duhet të paraqesin dokumentacionin e poshtëshënuar pranë Sektorit Juridik, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Bashkia Mallakastër.

Lista e dokumentacioneve të kërkuar i referohet parashikimeve të përcaktuara në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019:

1. Kriteri ekonomik pika 2.1 e VKM-së nr. 666/2019:

- Kërkesë nga nxënësi ose kryefamiljari drejtuar shkollës ose Bashkisë Mallakastër.
- Çertifikatë familjare dhe personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.
- Vërtetim për vlerën e ndihmës ekonomike kur familja e përfiton ose jo. Numri i dosjes, masa e plotë ose e pjesshme dhe shuma.
- Vërtetim për të ardhurat mujore të secilit anëtar të familjes mbi moshën 18 vjeç nga qendra e punës kur janë në marrëdhënie pune .
- Vërtetim për të gjithë anëtarët e familjes mbi 18 vjeç që janë të regjistruar si punëkërkues .

- Vërtetim për vëllezërit dhe motrat që janë nxënës ose student ku të jetë e përcaktuar nëse trajtohen ose jo me bursë dhe nëse kanë aplikuar për bursë për vitin përkatës.
- Vërtetim nga konvikti mbi regjistrimin apo pamundësinë për akomodim në të.

a. Kriteri i rezultateve të arritura pika 2.1 e VKM-së nr. 666/2019:

- Kërkesë nga nxënësi ose kryefamiljari drejtuar shkollës ose Bashkisë Mallakastër.
- Çertifikatë familjare dhe personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetëqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, si dhe nota mesatare e vitit paraardhës.

b. Kriteri jo ekonomik pika 2.3 e VKM-së nr. 666/2019:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari drejtuar shkollës së mësme për përfitim burse.
- Çertifikatë familjare dhe personale e nxënësit
- Vërtetim banimi nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.
- Nxënësit me statusin e jetimit duhet të paraqesin çertifikatën e vdekjes së të dy prindërve (specifike për shkronjën a).
- Nxënësi që ka humbur kujdestarinë prindërore të dorëzojë vendimin e gjykatës së formës së prerë të humbjes së kujdestarisë nga të dy prindërit (specifike për shkronjën b).
- Vërtetim origjinal ose fotokopje e noterizuar të lëshuar nga KMCAP (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë) për nxënësin me aftësi të kufizuar (specifike për shkronjën c, ç).
- Vërtetimi për pagesën e aftësisë së kufizuar të lëshuar nga zyra përkatëse (specifike për shkronjën c, ç).
- Vërtetim origjinal ose fotokopje e noterizuar të lëshuar nga KMCAP (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë) për prindin me aftësi të kufizuar (specifike për shkronjën d).
- Vërtetim për pagesën e aftësisë së kufizuar të lëshuar nga zyra përkatëse (specifike për shkronjën d).
- Vërtetim nga shoqata e Romëve (specifike për shkronjën dh).
- Vendim gjykate I formës së prerë që kanë humbur kujdesin prindëror (specifike për shkronjën e).
- Vërtetim nga Ministria e Brendshme që janë trajtuar si viktime të trafikut të qënieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror (specifike për shkronjën ë).
- Çertifikate vdekje të prindit që ka rënë në krye të detyrës. Vërtetim nga Ministria përkatëse që vërteton këtë status (specifike për shkronjën ë).

- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi (vajza), në cilën degë të përcaktuar në pikën 2.3, gërma f e VKM-së 666/2019 dhe në cilin vit shkollor është (specifike për shkronjën f).
- Çertifikate vdekje e prindit (specifike për shkronjën g).

ç. Kriteri i degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm:

Nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional në drejtimet mësimore bujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji- miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit duhet të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari drejtuar shkollës së mesme për përfitim burse.
- Çertifikatë familjare dhe personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga Njësia e Vetëqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.

Faleminderit për mirëkuptimin!

